

SHKURTIM VENDIMI
Nr. 16885, datë 17.10.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë prej:
Alma Kodraliu – gjyqtare,
asistuar nga sekretare gjyqësore Gencjana Dada, sot më datë 17.10.2024, mori në shqyrtim në seancë, çështjen tregtare që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “Plus Communication” sh.a., përfaqësuar nga administratore Matilda Shehu.

OBJEKTI: Hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Plus Communication” sh.a.

BAZA LIGJORE: Nenet 320, 334 të K.Pr. Civile; nenet 3, 4, 13, 14/1 dhe 15, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”,

VËREN:

Se, shoqëria “Plus Communication” sh.a. i është drejtuar kryesisht kësaj Gjykate, me kërkesën formale për hapjen e procedurave të falimentimit të saj mbështetur në ligjin nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306–308, të K.Pr.Civile, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuarit, “Plus Communication” sh.a.
2. Hapjen në orën 09:25, të datës 17.10.2024, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Plus Communication” sh.a., me administratore znj. Matilda Shehu, me seli në: rrugën “Reshit Çollaku, P. Shallvare, sh. 7, k. 4, ap. 97, Tiranë.
3. Emërimin si administratore të falimentimit, për shoqërinë “Plus Communication” sh.a., të znj. Shpresa Breçani, e regjistruar në listën e ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, me adresë: Rruga “Panorama”, pallati Sara – El, pranë Hipotekës Tiranë.
4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Plus Communication” sh.a. të paraqesin pranë administratores së falimentimit pretendimet e tyre brenda 45 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi në QKB.
5. Të gjithë kreditorët e Shoqërisë “Plus Communication” sh.a., të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.
6. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “Plus Communication” sh.a., t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratores së falimentimit znj. Shpresa Breçani.
7. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Plus Communication” sh.a. për raportim të mbahet brenda 60 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
8. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Plus Communication” sh.a., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

9. Urdhërohet publikimi i shkurtimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të publikohet shkurtimi i këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në Fletoren Zyrtare.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Plus Communication” sh.a. t’i njoftohet administratores së falimentimit, znj. Shpresa Breçani.

11. Një kopje e shkurtimit të vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Plus Communication” sh.a. t’i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Qendrore, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Plus Communication” sh.a. t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Plus Communication” sh.a. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Plus Communication” sh.a. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Plus Communication” sh.a. t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

16. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Plus Communication” sh.a. t’i dërgohet Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

17. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Plus Communication” sh.a. t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

18. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohet kërkuarit.

19. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 15 ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall sot, më datë 17.10.2024, në Tiranë, ora 09:25.

**GJYQTARE
Alma Kodraliu**